



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË**

---

Numri i lëndës: 2021:144852  
Datë: 28.03.2024  
Numri i dokumentit: 05516766

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Durim BALAJ, me bashkëpunëtoren profesionale Argjelina Prenku, në çështjen juridike të përmbarimit sipas propozimit për përmbarim të kreditorëve A.B., M.R., A.K., H.Z., A.B., që të gjithë nga Gjakova, të cilët sipas autorizimit i përfaqësojnë Fitim Gashi dhe Arben Biblekaj avokat në Prishtinë, kundër debitorës së përmbarimit Komunës së Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për përmbarimin e dokumentit të ekzekutueshëm – Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, C.nr.1007/21 të datës 14.11.2022, për shkak të kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit në punë si dhe kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, në shumën e përgjithshme prej 5,490.00 euro, duke vendosur për debitimin e mjeteve përmes xhironlogarisë bankare, jashtë seancës gjyqësore, më 28 mars 2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

I. URDHËROHET Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e Republikës së Kosovës në Prishtinë – Llogaria e vetme e Thesarit, që në emër të detyrimit të përcaktuar me Aktvendimin e kësaj gjykate, 2021:144852 të datës 30.03.2023, për lejimin e përmbarimit të dokumentit të ekzekutueshëm - Aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjakovë, C.nr.1007/21, të datës 14.11.2022, për shkak të kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit në punë si dhe kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, dhe atë:

- kreditores A.B., nga Komuna e Gjakovës, t'ia paguaj në emër të borxhit kryesor shumën prej 397.70 euro, në emër të kamatës ligjore prej 8% të borxhit kryesor shumën prej 42.45 euro,
- kreditores M.R., nga Komuna e Gjakovës, t'ia paguaj në emër të borxhit kryesor shumën prej 906.75 euro, në emër të kamatës ligjore prej 8% të borxhit kryesor shumën prej 96.79 euro,
- kreditores A.K., nga Komuna e Gjakovës, t'ia paguaj në emër të borxhit kryesor shumën prej 2,928.00 euro, në emër të kamatës ligjore prej 8% të borxhit kryesor shumën prej 312.53 euro,
- kreditorit H.Z., nga Komuna e Gjakovës, t'ia paguaj në emër të borxhit kryesor shumën prej 1,710.00 euro, në emër të kamatës ligjore prej 8% të borxhit kryesor shumën prej 182.52 euro,
- kreditores A.B., nga Komuna e Gjakovës, t'ia paguaj në emër të borxhit kryesor shumën prej 680.00 euro, në emër të kamatës ligjore prej 8% të borxhit kryesor shumën prej 72.58 euro,

si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore dhe përbarimore në shumën prej 2,278.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 9,607.33 euro, të gjitha në afat prej 7 ditësh, në atë mënyrë që nga xhirollogaria e debitores së përbarimit, Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, të barten këto mjetet monetare, në llogarinë e të autorizuarit të kreditoreve avokat Arben Biblekaj, në xhirollogarinë e tij bankare, me Nr....., në Bankën Kombëtare Tregtare-BKT.

II. OBLIGOHET pala kreditore dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Llogaria e vetme e Thesarit në Prishtinë, që gjykatën ta njoftoj me shkrim për zbatimin e këtij aktvendimi ose për arsyet e mos zbatimit të tij.

### A r s y e t i m

Gjykata duke vepruar sipas propozimit të kreditores së përbarimit, me aktvendimin 2021:144852, të datës 30.03.2023, ka lejuar përbarimin ndaj debitores Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit. Ndaj këtij aktvendimi, debitorja ka ushtruar prapësim me datë 19.04.2023, ndërsa i autorizuari i kreditoreve me datë 24.04.2023 ka paraqitur përgjigje në prapsim. Duke vendosur lidhur me prapësimin e debitores, gjykata me aktvendim 2021:144852, të datës 24.10.2023 ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e lartcekur.

Meqenëse palët kreditore në propozimin e tyre për përmbarrim, kanë cekur mjetin e përmbarrimit - transferimin e mjeteve monetare përmes xhirollogarive bankare e me qëllim të realizimit të detyrimit të lartë cekur në të holla, dhe pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës, kjo gjykatë gjeti se në rastin konkret, duhet të bëhet debitimi i mjeteve të lartcekura monetare, përkatësisht t'ia paguaj kreditorës A.B., nga Komuna e Gjakovës, t'ia paguaj në emër të borxhit kryesor shumën prej 397.70 euro, në emër të kamatës ligjore prej 8% të borxhit kryesor shumën prej 42.45 euro, kreditorës M.R., nga Komuna e Gjakovës, t'ia paguaj në emër të borxhit kryesor shumën prej 906.75 euro, në emër të kamatës ligjore prej 8% të borxhit kryesor shumën prej 96.79 euro, kreditorës A.K. nga Komuna e Gjakovës, t'ia paguaj në emër të borxhit kryesor shumën prej 2,928.00 euro, në emër të kamatës ligjore prej 8% të borxhit kryesor shumën prej 312.53 euro, kreditorit H.Z., nga Komuna e Gjakovës, t'ia paguaj në emër të borxhit kryesor shumën prej 1,710.00 euro, në emër të kamatës ligjore prej 8% të borxhit kryesor shumën prej 182.52 euro, kreditorës A.B., nga Komuna e Gjakovës, t'ia paguaj në emër të borxhit kryesor shumën prej 680.00 euro, në emër të kamatës ligjore prej 8% të borxhit kryesor shumën prej 72.58 euro, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore dhe përmbarrimore në shumën prej 2,278.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 9,607.33 euro, dhe atë për këto arsye:

Nga shikimi i shkresave të lëndës, 2021:144852, kjo gjykatë ka gjetur se në rastin konkret pjesë e detyrimit që rrjedh nga dokumenti i përmbarrimit – Aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjakovë, C.nr.1007/21, të datës 14.11.2022, i plotfuqishëm me datë 13.12.2022, dhe i ekzekutueshëm me datë 23.12.2022, për shkak të detyrimit në të holla, duke u bazuar në dokumentin e lartcekur të përmbarrimit, si dhe nenin 152 të LPP-së, debitorja, është e obliguar që kreditorëve të përmbarrimit, t'ia paguaj shumat e lartcekura të gjitha në afat prej 7 ditësh, andaj në arsyet e cekura më lart kjo gjykatë, vendosi që ta urdhëroj Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve në Prishtinë - Llogarinë e Thesarit, që të bëjë debitimin e mjeteve monetare si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të lartcekurat, gjykata duke u bazuar në nenet 3, 5 par.6 pika 2, 109 par.3, 113 dhe nenin 152 të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

### GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

- Departamenti i Përgjithshëm-

2021:144852, më 28 mars 2024

Numri i lëndës: 2021:144852  
Datë: 28.03.2024  
Numri i dokumentit: 05516766

GJYQTARI,  
Durim BALAJ

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesë e veçantë.